



KOMISIONI RREGULLATOR  
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË  
UJIT  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT



**NJOFTIM PËR OPINIONIN**

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit mori vendim, me të cilin bëhet rritja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 0,84 % në raport me vendimin e datës 6.09.2021.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 rriten për 1,00 denar/litër**, ndërkaq çmimet e shitjes me pakicë të **EURODIZELIT (D-E V) dhe të VAJIT EKSTRA TË LEHTË PËR AMVISËRI (EL-1) nuk ndryshojnë**, respektivisht mbeten në të njëjtin nivel, siç janë përcaktuar me vendimin e datës 06.09.2021.

Çmimi i shitjes me pakicë i **Mazutit M-1 SU rritet për 0,552 denarë/kilogram dhe tani do të jetë 38,395 den/kg.**

Nga data 14.9.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

<b>Benzinë për motorë</b>	<b>EUROSUPER BS - 95</b>	<b>73,00 (denarë/litër)</b>
<b>Benzinë për motorë</b>	<b>EUROSUPER BS -98</b>	<b>75,00 (denarë/litër)</b>
<b>Naftë për motorë</b>	<b>EURODIZEL BS (D-E V)</b>	<b>63,50 (denarë/litër)</b>
<b>Vaj për Djegie</b>	<b>Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)</b>	<b>63,00 (denarë/litër)</b>
<b>Mazut M-1 SU</b>		<b>38,395 (denarë/kilogram)</b>

Në periudhën e kaluar shtatëditore çmimet referente në bursat botërore shënojnë rritje: te benzina për 4,142 %, te nafta për 0,066 %, te vaji ekstra i lehtë ka ulje për 0,11 % dhe të mazuti ka rritje për 2,34% .

Në të njëjtën periudhë kursi i denarit në raport me dollarin është më i ulët për 0,343%.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 14.9.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së ([https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin\\_en](https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en) datë 6.9.2021) janë dhënë në tabelën në vijim në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të RMV-së [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk).

13.9.2021

